



Prishtinë, 26.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1209_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë të dorëzuar me 25.11.2019 për miratimin e dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë **26.12.2019**, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET BILANCI VJETOR I ENERGISË TERMIKE për vitin 2020 i N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë**

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2020 nga N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike" të dorëzuar nga N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2020" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
- IV. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc.



V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku gjithashtu do të publikohet edhe Bilanci unik i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, Anëtar



Izet Rushiti, Anëtar



Selman Hoti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2020, NQ Gjakova

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së